



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMORI LËNDËS  
Perkthim A-B

**Ngarkesa në orë/kredite:** 40 orë mësimore; 4kredite; . 10 leksione / 30 seminare

**Viti / Semestri :** Viti II; / Semestri II

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Bachelor në “Përkthim dhe interpretim në gjuhën greke dhe angleze”

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

**Objektivat e përgjithshme lëndore:** Ky kurs synon të njohë studentët me studimet e përkthimit si disiplinë të veçantë. Duke e trajtuar gjuhën si sistem, duke trajtuar përkthimin si proces dhe si produkt, si dhe duke ndërthurur zërbërthimin, interpretimin dhe qasjen e tekstit, jo vetëm në nivelin mikro, por edhe në nivelin makro, do t’u shërbejë studentëve të mund të strukturojnë dhe të përcjellin në gjuhën shqipe dhe anasjelltas efekte të barazvlefshme, ose të përafërta, në atë masë që lejojnë mjetet gjuhësore shprehëse të shqipes e të greqishtes, si dhe faktorë të tjerë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë. Nëpërmjet materialit gjuhësor problemor autentik, në përputhje me nivelin e njohurive të përftuara gjatë dy viteve të para e të gjitha zhanreve, stileve e regjistrave, si të gjuhës së shkruar e asaj të folur, do të mundësohet përfshirja dhe ndërthurja e me studimet Helenike, në mënyrë që studentët të njihen jo vetëm me gjuhën por edhe me jetën, kulturën, qytetërimin, institucionet etj.,

**Objektivat specifike lëndore:**

- 1.T’i njohë studentët me studimet e përkthimit si disiplinë e veçantë.
- 2.T’i ndërgjegjësojë studentët në lidhje me rolin e përkthimit në procesin e komunikimit dhe ndërthurjen e tij në proësin e mësimdhënies dhe nxënies së gjuhës greke nëpërmjet zhvillimit të kompetencave të ndryshme disiplinore, ndërdisiplinore dhe shumëdisiplinore. Në këtë kontekst, nëpërmjet trajtimit në planin praktik dhe teorik të dukurive gramatikore, leksikore dhe stilistike të gjuhëve greqisht e shqip, bazuar në parimin ‘pa probleme përkthimore, nuk mund të ketë teori përkthimi, mendohet dhe shpresohet që studentët të vendosin dhe të krijojnë një lidhje organike ndërmjet lëndëve të ndryshme dhe përkthimit në aspektin praktik dhe aplikativ në këndvështrimin e marrdhënieve shumëdisiplinore dhe ndërdisiplinore.